Nr.4239
Më dt. 27.10.2011.
Rahovec.

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 12 parag. 1, nën parag. 1.1, dhe nenit 20 parag.1 dhe 2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nr.03/L-149, lidhur me nenin 15 parag. 1 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit , Komuna e Rahovecit ri-shpall:

K O N K U R S

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Titulli vendit të punës : Arkitekt – (1) ekzekutues
Nr.i referencës: 3164 /2011
Grada-koeficienti; 6.
Lloji i emërimit: I karrierës
Kohëzgjatja: Zbatohet periudha provuese prej 12 muajve me mundësi të vazhdimit
Orari i plotë: 40 orë në javë

Kushtet për punësim

- Fakulteti i arkitekturës ose Bachelor
- Përvojë pune në profesion (përparësi)
- Njohja e punës me kompjuter dhe programeve Archikad, Autokad,GIS etj
- Trajnimet e ndryshme për aftësi organizative dhe komunikuese janë përparësi

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE KOMUNALE DHE EMERGJENCA

Titulli i vendit të punës: Inxhinier i ndërtimtarisë (1) ekzekutues
Nr. i referencës: 2416 /2011
Grada-koeficienti: 6.5
Lloji i emërimit: I karrierës
Kohëzgjatja: Zbatohet periudha provuese prej 12 muajve me mundësi të vazhdimit
Orari i plotë: 40 orë në javë

Kushtet për punësim

- Fakulteti i ndërtimtarisë ose Bachelor
- Përvojë pune në profesion (përparësi)
- Njohja e punës me kompjuter dhe programeve Archikad, Autokad,GIS etj
- Trajnimet e ndryshme për aftësi organizative dhe komunikuese janë përparësi

Kandidatët dokumentacionin e kompletuar si më poshtë e dorëzojnë në kopje si vijon;

- Dëshmi të kualifikimeve shkollore
- CV-në
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Letër rekomandimet,
- Kopjen e dokumentit të identifikimit

Detyrat dhe përgjegjësitë për të dy vendet e punës;

- Kryen punët profesionale teknike të planifikimit dhe rregullimit të hapësirës
- Hulumton kushtet lidhur me nevojat e planifikimit hapësinor dhe planifikimit urban
- Grumbullon, sistemon dhe përpunon të dhënat dhe informatat nga lëmi i planifikimit dhe rregullimit të hapësirës dhe mbrojtjes së mjedisit

- Bashkëpunon dhe merr pjesë në organizimin e takimeve për temat që kanë të bëjnë me procesin e planifikimit
- Kujdeset për implementimin e Planeve hapësinore, urbanistike dhe planeve të tjera dhe jep rekomandime
- Punon dhe harton projekte ideore, kryesore dhe dokumentacionin tjetër investues-teknik
- Merr pjesë në komisione të ndryshme profesionale
- Paraqet raporte periodike lidhur me punën e tij
- Kryen edhe punë të tjera të caktuara me ligj sipas kërkesës së drejtuesve në përputhje me kualifikimin profesional
- Kryerja e punëve në përputhje me ligjet, si dhe rregulloreve të Komunës së Rahovecit

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në zyrën e pranimit të administratës të Komunës së Rahovecit.
Afati i konkursit është 8 ditë, nga shpallja publike në faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit dhe në mjetet tjera të informimit.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për testim dhe intervistë.
Shërbimi Civil i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

.